



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:061847

Datë: 12.02.2024

Numri i dokumentit: 05315465

PPP.nr.50/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, si gjykatë e shkallës së parë, me gjyqtarin Baki Shigjeqi dhe bashkëpunëtoren profesionale H.D. në çështjen juridike përmbartimore ndërmjet kreditorit L.D. nga fshati komuna e Suharekës, të cilin me autorizim e përfaqëson N.H. avokate nga Suhareka, kundër debitorit M.H.V. nga Prizreni, lidhur me çështjen përmbartimore përmbushje e borxhit, vlera 40,000.00 €, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori, kundër Urdhrit për lejimin e përmbartimit numër P.nr.89/2022, të datës 01.03.2022, të lejuar nga Përmbartuesi Privat M.R. në Prizren, jashtë seancës gjyqësore, me datë 12.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET i pabazuar prapësimi i debitorit M.H.V. nga Prizreni, i ushtruar kundër Urdhrit për lejimin e përmbartimit P.nr.89/2022, të datës 01.03.2022, të lejuar nga Përmbartuesi Privat M.R. në Prizren.

II. DETYROHET debitori M.H.V. nga Prizreni, që kreditorit L.D. nga Suhareka, në emër të përgjigjes në prapësim t'ia paguajë shumën prej 208.00 €.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat M.R. në Prizren, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit L.D. nga fshati komuna e Suharekës, ka lëshuar Urdhër me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të Kontratës për Huan, me Nr.LRP:4776/2020, Nr.ref:950/2020, të datës 12.08.2020, me të cilin është lejuar përmbartimi i propozuar dhe debitori është obliguar që t'ia paguajë kreditorit shumën prej 40,000.00 €, në emër të përmbushjes së borxhit, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Kundër Urdhrit për lejimin e përmbartimit, brenda afatit ligjor, debitori ka paraqitur prapësim. Në prapësim ndër tjera pretendohet se propozimi për përmbartim është paraqitur në kundërshtim me nenin 71 par.1, nën par.1.7 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, pasi që propozimi për përmbartim është paraqitur para përmbushjes së detyrimit nga kontrata, duke theksuar se kreditori

nuk i ka dorëzuar të hollat e përcaktuara me kontratën në fjalë. Mbi bazën e këtyre pretendimeve, ka propozuar që urdhri përmbartimor të refuzohet-shfuqizohet si i pabazuar dhe të obligohet kreditori që të bëj paguaj shpenzimet e prapësimit.

Kreditori ka ushtruar përgjigje në prapësim përmes të autorizuarës së tij, në të cilën ka theksuar se sipas nenit 1 të Kontratës, huamarrësja M.H.V. është pajtuar që të ja lëshoj huanë e pranuar përmes transaksionit bankar të cilën e ka bërë në bankën NLB, me datë 20.12.2019 dhe me datë 10.01.2020, e për të vërtetuar faktin se të hollat i janë dorëzuar kreditorit tek debitori dhe se nuk është e vërtetë se nuk ka dëshmi bankare, si prova materiale së bashku me përgjigjen në prapësim ka paraqitur edhe transaksionet bankare. Tutje ka shtuar se sipas kontratës dhe dëshmive të vërtetuara nga banka për dërguesin, në rastin konkret kreditori dhe përfituesen, këtu debitoren, shuma e përgjithshme është euro, krejt sipas dokumentit përmbartues. Andaj bazuar në Ligjin për Procedurën Përmbartimore, janë plotësuar kushtet që Përmbartuesi Privat sipas Dokumentit Përmbartues noterial Kontrata LRP 4776, Nr. Ref., të datës 12.08.2020, të lëshon Urdhërin Përmbartimorë. Mbi bazën e këtyre pretendimeve, ka propozuar që të refuzohet si i pa bazuar prapësimi i debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhëri përmbartimor, si dhe të obligohet debitorja që të paguan shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të debitorës të paraqitura në prapësim, pretendimeve të të autorizuarës së kreditorit të paraqitura në përgjigje në prapësim si dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se prapësimi është i pa bazuar për arsyet në vijim: Dispozita nga neni 22 par.1 e LPP-së, e cila përcakton llojet e dokumenteve përmbartuese, në nenin par 1.3 parasheh që: *“dokumenti noterial i përmbartueshëm në pajtim me ligjin për noterinë;”*. Tutje, dispozita nga neni 26 par.1 e LPP-së parasheh që: *“Dokumenti i noterizuar është i përmbartueshëm nëse është bërë i përmbartueshëm sipas rregullave të veçanta që rregullojnë përmbartueshmërin e atij dokumenti.”*. Në anën tjetër, neni 27 par.1 i LPP-së përcakton elementet që duhet t'i përmbajë një dokument përmbartimor në mënyrë që të jetë i përshtatshëm për përmbartim. Kjo dispozitë parasheh që *“Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*. Referuar mënyrës se si është formuluar, rrjedh se dispozita në fjalë kërkon që elementet e renditura më sipër duhet të përmbushen në mënyrë kumulative, në mënyrë që dokumentit mbi bazën e të cilit është lejuar përmbartimi t'i njihet cilësia e dokumentit të përshtatshëm për përmbartim.

Në rastin konkret, përmbartimi është lejuar në bazë të Kontratës për Huan, me Nr.LRP:4776/2020, Nr.ref:950/2020, të datës 12.08.2020. Nga vlerësimi i këtij dokumenti, Gjykata gjen se i njëjti paraqet dokument noterial, si dhe përmban të dhëna për kreditorin, debitorin, objektin, mjetet, shumën dhe kohën e përmbushjes së detyrimit dhe si i tillë i përmbushë të gjitha kriteret ligjore të përcaktuara nga nenet 22, 26 dhe 27 të LPP-së për tu konsideruar i përshtatshëm për përmbartim, në kuptim të dispozitës nga neni 21 të LPP-së, e cila parasheh që: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*.

Gjykata me rastin e vendosjes trajtoi pretendimet e ngritura nga ana e debitorës lidhur me faktin se propozimi për përmbartim është paraqitur para përmbushjes së detyrimit nga kontrata, përkatësisht kreditori nuk i ka dorëzuar të hollat e përcaktuara me kontratën në fjalë, të cilat pretendime i vlerësoi si të pabazuara.

Lidhur me këto pretendime, Gjykata iu referua provave materiale të bashkangjitura me përgjigjen në prapësim nga ana e të autorizuarës së kreditorit dhe atë: Informata për Bankën dërguese dhe Informata për Bankën përfituese, sipas të cilës konstatohet se kreditori L.D. me datë 20.12.2019, kishte transferuar shumën prej euro në llogari të debitores M.H. në emër të Huasë për 3 muaj, si dhe Informata për Bankën dërguese dhe Informata për Bankën përfituese, sipas të cilës konstatohet se kreditori L.D. me datë 10.01.2020, kishte transferuar shumën prej 20,000.00 euro në llogari të debitores M.H. në emër të Huasë për 3 muaj. E po ashtu në nenin 1, të kontratës për huan të datës 12.08.2020, është përcaktuar Objekti i kontratës dhe në të njëjtën është përcaktuar që huadhënësi i jep huamarrësit shumën e të hollave në lartësi prej euro, e për të cilën kontraktuesit janë pajtuar që huaja të lëshohet përmes transaksionit bankar në bankën NLB, me datë 20.12.2019 dhe 10.01.2020, të cilat të holla duhej ti kthehen huamarrësit, në rastin konkret kreditorit, deri me datë 30.09.2020.

Në bazë të të lartcekurave, Gjykata vlerëson se pretendimet e parashtruara nga ana e debitores janë të pa bazuara dhe rrjedhimisht pa ndikim në një vendosje ndryshe e cila do të rezultonte me aprovimin e prapësimit dhe anulimin e Urdhërit Përmbarimor. Mbi këtë bazë, vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke e refuzuar prapësimin e debitorit dhe duke e lëndë në fuqi Urdhërin Përmbarimor të goditur me prapësim.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës, si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, Gjykata e mbështeti në dispozitat nga nenet 463 të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 13 paragrafi 4 të LPP-së, duke e obliguar debitorin që kreditorit, në emër të përgjigjes në prapësim t'ia paguajë shumën prej 208.00 €, konform Tarifës së Odës së Avokatëve. Mbi bazën e arsyeve të lartcekura, në kuptim të dispozitës nga neni 73 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL
2022:061847, 12.02.2024

G j y q t a r i

Baki Shigjeqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.